

E.S.H.

FROM :

FAX NO. : 517153

Jan. 16 2005 11:27:11 P1



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil

UDHEZIM

Nr. 3207, Date 01.11.2005

MBI

**LICENSIMIN E SUBJEKTEVE SHTETERORE DHE PRIVATE
QE KYEJNE AKTIVITETIN E SHERBIMEVE
NE FUSHEN E AVIACIONIT CIVIL**

Ne zbatim te Nenit 102 (pika 4) te Kushtetutes dhe te Ligjit Nr. 7877, date 30.11.1994 "Per Aviacionin Civil Shqiptar" (neni 9), per permiresjmin e procedurave per licensimin e subjekteve shteterore dhe private qe kryejne aktivitetin e sherbimeve ne fushen e aviacionit civil dhe aplikimin e standarteve e praktikave rekomanduese te sanksionuara ne Aneksin 1, te ICAO-s,

UDHEZOJ :

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Qellimi i këtij Udhezimi është përcaktimi dhe miratimi i procedurave standarte në licensimin e subjekteve shtetërore dhe private që kryejnë aktivitetin e shërbimeve në fushën e aviacionit civil, mbrojtja e interesave të zhvillimit të aviacionit civil, të subjekteve dhe sigurisë së aktiviteteve të shërbimeve në aviacionin civil.

Neni 2

Per qellim të këtij Udhezimi, përcaktimet e mëposhtme nënkuptojnë :

1. "**Aerodrom**" - një zonë e caktuar mbi tokë ose ujë, që përfshin pistat, ndërtesat, instalimet dhe pajisjet, të cilat do të përdoren tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, ngritjen dhe levizjen në sipërfaqe të avionëve.
2. "**Avion**" - një mjet fluturues me i rende së ajri, i vënë në levizje nga një fuqi motorike, ngritja e të cilit në dhe gjatë fluturimit, krijohet kryesisht me anë të një reaksioni aerodinamik mbi sipërfaqen e avionit, i cili mbetet fiksisht në kushtet e dhëna të fluturimit.
3. "**Vend-Qendrim i avionëve**" - një zonë e përcaktuar në një aerodrom, për qëndrimin e avionëve, që ka për qëllim ngarkimin-shkarkimin e pasagjerëve, kargos, postës, furnizimin me karburant, parkimin ose mirëmbajtjen, etj.
4. "**Pako**" - një produkt komplet dhe përmbajtja e tij, i përgatitur për transport.
5. "**Kargo**" - çdo ngarkesë e pranuar, për qëllim të transportit ajror, e kryer nga kompanitë ajrore, që përfshin postën dhe mallrat.
6. "**Handling**" - një shërbim i kryer për qëllim të transportimit dhe të përpunimit të mallrave brenda një aeroporti.
7. "**Autoritet kompetent të licenses**" - nënkupton autoritetin e caktuar nga një shtet që përgjegjës për leshimin e licensave të personelit të aviacionit.

8. "Autoritet" - nënkupton DPAC në varësi të Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacionit.

9. "Organ kontrollues" - nënkupton një organ (person) të emëruar në këtë detyrë nga autoriteti, për qëllim të këtij Udhëzimi.

10. "License perkatese" - nënkupton në bazë të këtij Udhëzimi një license, e cila titullon mbajtësin të kryejë funksionet në lidhje me shërbimin, që përfshihen në license.

11. "Licensim" - nënkupton dhenien e një leje zyrtare për të ushtruar një aktivitet të caktuar shërbimi në fushën e aviacionit civil.

KAPITULLI II

LICENSIMI I SUBJEKTEVE PËR USHTRIMIN E NJE AKTIVITETI TË CAKTUAR SHËRBIMI NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL

Neni 3

Licensat për subjektet që ushtrime një aktiviteti të caktuar shërbimi në fushën e aviacionit civil, leshohen nga Drejtoria Përgjithshme e Aviacionit Civil.

Neni 4

Licensat do të leshohen për ushtrimin e veprimtarisë së mëposhtme:

1. Administrata e shërbimit në tokë dhe supervizioni, ku përfshihen:

a) Shërbimet e përfaqësimit dhe të lidhjes me autoritetet qendrore dhe lokale apo çdo njësi tjetër zërbërëse të shpenzimeve në emër të përdoruesit të aeroportit dhe garantimi i sipërfaqes për zyrë për përfaqësuesit e tij;

b) Kontrolli i ngarkesës (load control), mesazhet dhe telekomunikimi;

c) Përpunimi (handlingu), depozitimi dhe administrimi i njësive së mjeteve të ngarkimit (load devices);

d) Cdo sherbim tjetër supervizimi përpara, gjatë dhe mbas fluturimit si dhe cdo sherbim tjetër administrativ të kërkuar nga përdoruesi i aeroportit

2. Përpunimi i pasagjereve, përfshin cdo lloj asistencë në mbërritje, nisje, transferim apo pasagjer tranzit, përfshirë kontrollin e biletave dhe dokumentave të udhëtarit, regjistrimi i bagazheve dhe transporti i tyre në zonën e daljes.

3. Përpunimi i bagazheve, përfshin përpunimin (handlingun) e bagazheve në zonën e daljes, daljen, përgatitjen për nisje, ngarkimin dhe shkarkimin nga mjeti i transportit për të dërguar nga avioni në zonën e daljes dhe e kundërta, si dhe transportin e bagazheve nga zona e daljes në zonën e reklamimit.

4. Përpunimi i ngarkesës dhe postes, përfshin:

a. Për mallrat: përpunimin fizik të mallrave të eksportit, transferimit dhe importit, përpunimi i dokumentave që lidhen me to, procedurat doganore dhe zbatimin e cdo mase të sigurisë të rene ndërmjet paleve ose që kërkohet nga rrethanat;

b. Për posten: përpunimin fizik të postes në hyrje dhe në dalje, përpunimi i dokumentave që lidhen me to, dhe zbatimin e cdo mase të sigurisë të rene ndërmjet paleve.

5. Përpunimi i RAMP përfshin:

a. Marshallimi i avionit në tokë, në mbërritje dhe në nisje;

b. Asistencë për avionin dhe sigurimi i paisjeve të nevojshme;

c. Komunikimi ndërmjet avionit dhe furnizuesve të shërbimit të pistes (air side);

d. Ngarkimi dhe shkarkimi i avionit për shpërndarjen e operimeve me mjetet e nevojshme si dhe transporti i ekuipazhit, pasagjereve dhe bagazheve nga avioni në terminal dhe e kundërta;

e. Sigurimi dhe operimi i pjesëve të nevojshme për lëshimin e motorrave të avionit;

f. Levizja e avionit në nisje dhe në mbërritje, si dhe sigurimi dhe operimi i paisjeve të nevojshme;

g. Transporti, ngarkimi dhe shkarkimi nga avioni i ushqimeve dhe pijeve.

6. Shërbimet e avionit përfshijnë:

a. Pastrimi i jashtëm dhe i brendshëm i avionit dhe shërbimet e tualetit dhe furnizimit me ujë;

b. Ftohja apo ngrohja e kabines, heqja e borës dhe akullit, de-icing i avionit;

c. Rirregullimi i kabines me paisjet e nevojshme.

7. Furnizimi me karburant dhe lubrifikante përfshijne:

- a. Organizimi dhe zbatimi i operimeve të furnizimit me karburant, përfshi kontrollin e cilësisë dhe sasise të karburantit të furnizuar;
- b. Zëvendësimi i vajit dhe lëngjeve të tjera

8. Mirembajtja e avionit përfshin:

- a. Shërbimet e zakonshme të avionit përpara nisjes;
- b. Shërbimet e kërkuara nga përdoruesi i aeroportit;
- c. Sigurimi dhe administrimi i pjesëve të këmbimit;
- d. Rezervimi i hapësirës së parkimit ose vendit në hangar.

9. Operimet e fluturimit dhe administrimi i ekipazhit përfshin:

- a. Përgatitja për fluturim në aeroportin e nisjes;
- b. Asistenca në fluturim;
- c. Aktivitetet pas fluturimit;
- d. Administrimi i ekipazhit.

10. Transporti sipërfaqësor përfshin:

- a. Organizimin dhe zbatimin e transportit të ekipazhit, të pasagjerëve, bagazhëve, mallrave, postës ndërmjet terminalëve të ndryshëm të të njëjtit aeroport, por përjashtuar të njëjtin transport ndërmjet avionit dhe një pike tjetër brenda perimetrit të të njëjtit aeroport;
- b. Cdo transport i vecantë i kërkuar nga përdoruesi i aeroportit

11. Shërbimet e kateringut përfshijne:

- a. Lidhjen ndërmjet furnizuesit dhe menaxhimit administrativ, depozitimi i ushqimeve dhe pijeve si dhe paisjeve të nevojshme për përgatitjen e tyre;
- b. Magazinimin e ushqimeve, pijeve dhe të paisjeve, që nevojiten për përgatitjen e tyre;
- c. Pastërimi i këtyre paisjeve;

d. Përgatitja dhe levrimi i pajisjeve dhe i ushqimeve dhe i pijeve.

12. Shërbimet e sigurimit (security) përfshijnë:

a. Kontrollin e pasagjerëve dhe të bagazheve të dorës;

b. Kontrollin 100% të bagazheve;

c. Kontrollin e kargos, cateringut, postës dhe dokumentave të udhëtitimit ruajtjen (statike dhe me patrulla);

d. Kontrollin e hyrjeve;

e. Lëshimin e kartave të identitetit të Aeroportit;

f. Kontrollin me Televizion me Qark të Mbyllur (CCTV);

g. Trainim dhe Punësim të Agjentëve të Sigurisë së Aviacionit dhe Kontrolloreve shërbime shtesa të sigurisë së aviacionit.

Neni 5

Drejtori i DPAC, miraton Urdhërin për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të kërkesave për lëshimin e licensave, përcakton përberjen dhe procedurat e tij.

Komisioni shqyrtimit të kërkesave për lëshimin e licensave, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm subjektet që protestojnë kërkesat për marrjen e licensave në përputhje me këtë Udhezim.

Komisioni mblidhet në rastet e shqyrtimit të kërkesave për licensim ose shqyrtimit të ankesave.

Neni 6

Të gjitha kërkesat dhe dokumentacioni i subjekteve për ushtrimin e një aktiviteti të caktuar shërbimi në fushën e aviacionit civil, të përcaktuar sipas Nenit 1, dorëzohen në komisionin e shqyrtimit të kërkesave.

Neni 7

Komisioni shqyrtimit të kërkesave për lëshimin e licensave, verifikon rregullshmerinë ligjore të kërkesave në zbatim të këtij Udhezimi.

Dokumentat konsiderohen zyrtarisht të dorëzuara, në datën në subjektin ka dorëzuar dokumentacionin sipas kërkesave të këtij Udhezimi. Komisioni ka të drejtën e komunikimit zyrtar me subjektin dhe të japë sqarime për plotësimin e dokumentave.

Neni 8

Dokumentacioni i shprehendhet anetareve te Komisionit te shqyrtimit te kerkesave per leshimin e licensave (5) pese dite para mbledhjes

Neni 9

Komisioni shqyrtimit te kerkesave per leshimin e licensave merr vendim jo me vone se 30 dite nga dita e dorezimit te dokumentacionit te putesuar nga subjektet sipas kerkesave te ketij Udhhezimi.

Komisioni i shqyrtimit te kerkesave per leshimin e licensave pergatit Verdimin me shkrim te nenshkruar nga te gjithe antaret prezent ne dite mbledhjes, por jo me pak se 50 % plus nje, i detyruar te miratohet nga Drejtori Pergjithshem i DPAC.

Neni 10

Komisioni shqyrtimit te kerkesave per dhënien e licensave pergatit Licensa ku percaktohet illoji i aktivitetit operues te subjektit per ushtimin e nje aktivitei te caktuar sherbimi ne fushen e aviacionit civil, te percaktuar sipas Nenit 1.

Licensa nenshkruhet nga Drejtori Pergjithshem i DPAC.

Neni 11

Dokumentacioni i subjekteve dhe praktikat arshivoher ne Sekretarinne e Komisionit Dokumentacioni ruhet per nje periudhe 5 vjecare dhe pas ketij afati dorezohet ne arshiven cendrore te DPAC.

Neni 12

Ne rastin e kerkeses per perseritjen e licenses pervec dokumentacionit qe do te kerkohet sipas kerkesave te meposhteme, Komisioni shqyrtimit te kerkesave per leshimin e licensave mund te kërkoje nga subjekti qe te dhena shtese, te cilat gjykohen te nevojshme nga autoriteti i licensimit.

Neni 13

Formatet e licensave per cdo subjekte per ushtimin e nje aktiviteti te caktuar sherbimi ne fushen e aviacionit civil, pergatiten nga DPAC dhe miratohen nga Drejtori i Pergjithshem.

Neni 14

Koha-zgjatja e licenses te jete nga nje vit deri ne pese vit, me te drejte perseritje.
Koha-zgjatja e licenses qe leshohet per here te para te jete nje vjecare.

Neni 15

Mbajtësi i licencës nuk mund të kryejë ndonjë lloj tjetër shërbimi, i cili nuk përfshihet në licencë dhe nuk duhet të lejojë që licenca e tij të përdoret nga persona të tjerë.

Neni 16

Kontrolli për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me kërkesat e një licencë të lëshuar një subjekti të caktuar, do të kryhet nga DPAC.

Neni 17

Për shkeljet e konstatuara nga subjektet e shërbimeve merren masa sipas kompetencave të organeve kontrolluese administrative dhe der heqjen e përkoheshme ose të përhershme të licencës.

Për masat e marra subjekti i lindur e drejta e ankimit brenda 10 ditëve tek Drejtori Përgjithshëm i DPAC, i cili vendosë për heqjen, lëvizjen ose ndryshimin e masës së marrë.

KAPITULLI III**KERKESAT PËR LICENSIMIN****Neni 18**

Cdo subjekt që kërkon të ushtrojë një aktivitet të caktuar shërbimi në fushën e aviacionit civil sipas Nenit 1, duhet të zbatojë kriteret e nevojshme për lëshimin e licencave.

Kriteret për lëshimin e licencave përfshijnë aftësitë e shërbimit, ngjashmëri tekniko-profesionale, reputacionin e mirë, besueshmërinë financiare si dhe gjendjen e mirë teknike të mjeteve.

Neni 19

Kriteret për lehtësim dhe licencave janë inkluduar në dokumentat e mëposhteme, të cilat në çdo rast janë pjesë e grupimit të dokumentave, të subjekti paraqet kur kërkon licensim për një veprimtarë të caktuar shërbimi në fushën e aviacionit civil:

1. Kërkesën për licensim;
2. Llojin e veprimtarisë në aviacionin civil që kërkohet të zhvillojë;
3. Llojin e licensit (për here të parë apo përsëritje);
4. Adresën e subjektit;
5. Inventarin e mjeteve apo makinerive dhe të pajisjeve që do të përdoren;

Neni 20

Në kërkesën e subjektit për licensim për një veprimtarë të caktuar shërbimi në fushën e aviacionit civil duhet të paraqiten:

a) Dokumentat ligjore të nënlimit të subjektit

- Aktin e themelimit Statutin dhe Venjimin e Gjykatës për themelimin e subjektit subjektit juridik ose fizik:

Në objektin e veprimtarisë së subjektit juridik ose fizik duhet të jete specifikuar llojit të aktivitetit sipas aktivitetit të shërbimit të aviacionit civil.

b) Dokumentacioni për strukturën e subjektit

1. Numrin dhe emrat e punonjësve të subjektit për ushtrimin e aktivitetit të caktuar shërbimi në fushën e aviacionit civil.
2. Strukturën e organizimit të subjektit dhe edukimin profesional të punonjësve të saj;
3. Programet e trajnimit dhe kualifikimit të tyre;
4. Literaturën për ushtrimin e aktivitetit: Anekset e ICAO-s, Ligjet e aviacionit, rregullat e operimit, et.).

c) Dokumentacioni financiar

1. Biznes Planin e subjektit për ushtrimin e aktivitetit;
2. Vërtetimin për hapjen e numurit të llogarive në një nga bankat e sistemit bankar të RSH;
3. Vërtetimin për regjistrimin në zyrën e Tatimit dhe Taksave.

d) Dokumenta të tjera

1. Gënjë planin dhe planimetritë e vendosjes së objekteve, të mjeteve të operimit dhe zyrave;
2. Sigurimin e mjeteve ose garancinë bankare përkatëse;
3. Deklaratën për dërgimin rregullisht sipas afatëve të të dhënave statistikore në lidhje me zhvillimin e aktivitetit.
4. Dëshmi penaliteti, për pronarin dhe për të gjithë personat fizikë të përfshirë në strukturën organizative të subjektit

Neni 21

Dokumentacioni i kërkuar sipas nenit 20 duhet te jete origjinal ose fotokopje e noterizuar.

Neni 22

Procedurat dhe kriteret per licensimin e kryerjes se operimeve te cdo sherbimi te vecante aeroportual du te pershkruhen nga DPAC

Neni 23

Ne rast te rinovimit te licenses subjekti juridik ose fizik duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme:

- i. Vendimin e Gjykeses (nese ka ndryshime);
- ii. Fregjistrimin tatimor te subjektit dhe numrin i fregjistrimit ne Organin Tatimor.
- iii. Vertetimin nga banka ku subjekti juridik ose fizik ka llogarinet rrjedhese.
- iv. Evidencat statistikore vjetore.
- v. Dokumentin e vertetimit te shlyerjes se detyrimit fiskal.

Neni 23

Ne rast se subjekti i kerkeses per licensimin eshte person fizik ose juridik i huaj duhet te depozitohen edhe dokumentacionet e meposhtme:

1. Kerkesen nga pronari ose operatori i sherbimit aeroportual;
2. Dokumentat ligjore per statusin si pronar ose statusin si subjekt, qe ka marre me nenkontraktim ose qera sherbimit qe do te kryeje;
3. Dokumentin per vertetimin e kredibilitetit financiar (bankar);
4. Deklaraten e informimit periodik te te dhenave statistikore;
5. Dokumentat e sherbimit, qe do te kryeje;
6. Kontraten e qeramarrjes, ne se kerkuesi nuk eshte pronar i mjeteve qe do te operoje;
7. Kontraten me Entin, qe do te operoje;
8. Kontratat e cunes me te punesuant;
9. Projekt tarifat qe do te perdore.

Dokumentat te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara.

Documentat per rinovimin e licenses nga personi fizik ose juridik i huaj :

1. Kërkesa për rinovimin e licenses;
2. Vondimi i regjistrimit ne Gjykatën e Rrethit;
3. Dokumenti i regjistrimit për tatum-taksa;
4. Vërtetim për pagimin e taksave të percaktuara
5. Licensen e meparshme ;
6. Te dhenat statistikore ekonomike të aktivitetit të kryer.

KAPITULLI IV

PAVLEFSHMERIA E LICENSES

Neñi 25

- a) Licensa behet e pa vlefshme, ne rast se subjekt juridik ose fizik nuk e fillon aktivitetin e veprimtarise ne fushen e aviacionit civil, brenda 90 diteve nga dita e leshimit te saj
- b) Subjektit i hiqet licensa ne rast se noerpret veprin tarine ne aviacionin civil, me shume se 10 dite vazhduese brenda nje vi i.

Ky Udhezim hyr ne fuqi menjehere.

